



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

**REZOLUTË**

**SHMANGIA E KRIZËS KUSHTETUESE ME SYNIM LEGJITIMITETIN  
E GJYKATËS KUSHTETUESE - DETYRË IMPERATIVE E ORGANEVE  
MË TË LARTA TË SHTETIT**

**Kuvendi i Shqipërisë:**

- Duke vlerësuar se Gjykata Kushtetuese është një organ kushtetues që ka për mision ruajtjen e kushtetutshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se kjo Gjykatë garanton zbatimin e parimeve themelore kushtetuese nga të gjitha institucionet kushtetuese;
- Duke vlerësuar se rifillimi i funksionimit të Gjykatës Kushtetuese është jetik, ndër të tjera, për zbatimin e objektivave kushtetues të kontrollit dhe balancave midis pushteteve të shtetit dhe garantimit të të drejtave themelore të njeriut;
- Duke vlerësuar se ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, në kuadër të Reformës në Drejtësi, që rivendosën ekuilibra kushtetues për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë, sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve, kanë përcaktuar qartë rregullat për procesin e emërimit dhe zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, duke përfshirë kriteret dhe procedurën përkatëse për përzgjedhjen e kandidaturave, në respektim të pavarësisë, paanshmërisë dhe parimit të luajalitetit kushtetues;
- Duke vlerësuar mekanizmin zhbllokues në procesin e emërimit në organet e sistemit të drejtësisë, si një nga elementet thelbësore të Reformës në Drejtësi, i orientuar, por edhe i mbështetur njëkohësisht edhe në opinionet *amicus curiae* të Komisionit të Venecias, që kanë

përcaktuar rëndësinë dhe nevojën e mekanizmit zhblokues, me qëllim funksionimin dhe mospengimin e organeve kushtetuese;

- Duke mbështetur fuqimisht zbatimin e Reformës në Drejtësi si kriter kyç për sundimin e ligjit dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, si dhe për të ardhmen europiane të vendit, reformë që vlerësohet me nota shumë pozitive në progresraportet e Komisionit Europian dhe ku Shqipëria veçohet si shembull për t'u ndjekur nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor;

- Duke vlerësuar dhe inkurajuar ecurinë e zbatimit të Reformës në Drejtësi, e reflektuar në ngritjen dhe funksionimin e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, si Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe në hapat e ndërmarrë për plotësimin sa më të shpejtë të vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, për ngritjen e prokurorisë dhe gjykatës speciale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm;

- Duke vlerësuar punën e deritanishme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për procedurën e ndjekur mbi renditjen e kandidatëve sipas meritës profesionale e morale, në funksion të plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese;

- Duke përshëndetur emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, konkretisht z. Besnik Muçi emëruar me dekretin e Presidentit të datës 18 tetor 2019, emërimin e znj. Arta Vorpsi si anëtare e Gjykatës Kushtetuese në datë 8 nëntor 2019, pas përfundimit të afatit, brenda të cilit duhej të shprehej Presidenti i Republikës, si dhe zgjedhjen e znj. Elsa Toska dhe znj. Fiona Papajorgji nga Kuvendi si anëtare të Gjykatës Kushtetuese;

**Kuvendi i Shqipërisë, pasi u informua se Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr. 11 350, datë 13.11.2019, “Për emërimin e znj. Marsida Xhaferllari si anëtare e Gjykatës Kushtetuese”, dhe duke konsideruar nxjerrjen e këtij akti në kundërshtim të hapur dhe flagrant me dispozitat kushtetuese dhe ligjore dhe në tejkalim të kompetencës kushtetuese të Presidentit të Republikës, veprim i cili delegjtitimon, që në fillim, funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, konstaton:**

- Kushtetuta përcakton qartë se në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese emërohen/zgjidhen gjyqtarët nga Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë. Këto organe e ushtrojnë në mënyrë krejt të pavarur kompetencën kushtetuese dhe pa asnjë lloj ndërvarësie mes tyre. Të tre këto organe kufizohen të emërojnë/zgjedhin midis tre emrave të kandidatëve, të listuar të parët nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Për Kuvendin dhe Presidentin, përveç kufizimit të emërimit/zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues nga kandidatët e listës që miraton Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka dhe një kufizim kohor për ushtrimin e kompetencës brenda një afati prekluziv tridhjetëditor. Mosushtrimi i kompetencës brenda këtij afati, nga Presidenti dhe Kuvendi, sjell emërimin si gjyqtar kushtetues të kandidatit të renditur i pari në listën e miratuar me vendim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, (neni 125 i Kushtetutës, nenet 7/b, 7/c dhe 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar).

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 8.10.2019 i ka dërguar Presidentit vendimet e tij në lidhje me dy vakanca të krijuara në Gjykatën Kushtetuese, duke i vënë në dispozicion dy lista me kandidatë për secilin vend vakant, me qëllim ushtrimin e kompetencës së tij për të emëruar dy gjyqtarë kushtetues. Me dekretin e datës 18.10.2019, Presidenti ka emëruar z. Besnik Muçi si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, ndërsa për vendin e dytë vakant ka zgjedhur të heshtë. Me kalimin e afatit prekluziv tridhjetëditor, në datën 7.11.2019, znj. Arta Vorpsi, e renditur e para në listën e miratuar me vendim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konsiderohet *ex lege*, e emëruar anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

- Me nxjerrjen e dekretit nr. 11 350, datë 13.11.2019, Presidenti i Republikës, duke emëruar kandidatin tjetër jashtë afatit 30-ditor, të përcaktuar shprehimisht nga ligji kushtetues, ka shkelur njëkohësisht jo vetëm afatin prekluziv, brenda të cilit duhej të emëronte gjyqtarin kushtetues midis tre kandidaturave të listuara të parat në vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, por ka emëruar si gjyqtar një kandidat që është listuar në vendin e katërt, sipas vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Afati tridhjetëditor për Presidentin ka mbaruar në datën 7.11.2019, pasi vendimi nr. 132, datë 21.9.2019, i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i është njoftuar Presidentit në datën 8.10.2019 dhe renditja e kandidatëve në listën e miratuar me këtë vendim është: 1. Arta Vorpsi; 2. Fiona Papajorgji; 3. Elsa Toska; 4. Marsida Xhaferllari.

- Duke emëruar kandidatin e listuar në vend të katërt në vendimin nr. 132, datë 21.9.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, me justifikimin se zgjedhja e dy prej kandidatëve në të njëjtën listë si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese me vendimin e Kuvendit të datës 11.11.2019, e rendit kandidatin e zgjedhur si gjyqtar kushtetues nga Presidenti në tre vendet e para të listës, Presidenti ka marrë në mënyrë abuzive kompetencat e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organi i vetëm kushtetues që përcakton renditjen e tre të parëve si kandidatë, ndërmjet të cilëve duhet të emërojë ose zgjedhë Presidenti ose Kuvendi. Qëllimi i këtij rregulli kushtetues dhe ligjor është kufizimi i diskrecionit për të tre organet e emërtesës, përkatësisht Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, për të vendosur brenda renditjes së përcaktuar në vendimin e këtij Këshilli.

- Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se dekreti i Presidentit nr. 11 350, datë 13.11.2019, i nxjerrë tej afatit prekluziv 30-ditor, është një akt absolutisht i pavlefshëm, në mungesë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit të Presidentit dhe si i tillë konsiderohet nul dhe sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë.

- Në mungesë të kompetencës për të emëruar gjyqtarin kushtetues, Presidenti, në mënyrë të kundërligjshme, ka ndërhyrë në një proces kushtetues. Argumentet e Presidentit në letrën e datës 5.11.2019 drejtuar Kuvendit dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në lidhje me radhën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues nga Presidenti e Kuvendi, bien ndesh me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, për arsye se radha nuk përcakton kohën e veprimit të organit, por kompetencën për të vepruar për secilin vend vakant. Në kushtet kur kërkohet të plotësohen disa vende vakante njëherësh, secili organ ka të drejtë të ushtrojë kompetencën e vet kushtetuese, pa u kufizuar nga zgjedhja e organit tjetër dhe as nga koha e ushtrimit të kësaj kompetence prej secilit organ. Emërimi/zgjedhja e gjyqtarit/gjyqtarëve kushtetues kryhet në mënyrë të pavarur nga vendimmarrja e organit tjetër. Nga procedura tërësore e ndjekur, që nga shpallja e vendeve vakante për gjyqtarët kushtetues, nga Presidenti ashtu dhe nga Kuvendi, deri në shqyrtimin, vlerësimin e kandidaturave dhe njoftimet e vendimeve përkatëse të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për secilin vend vakant të krijuar, është e qartë kompetenca e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues për vendin vakant respektiv, përkatësisht nga Presidenti dhe nga Kuvendi.

- Duke vepruar në shkelje të hapur dhe flagrante të Kushtetutës dhe të ligjit dhe në mungesë të kompetencës, Presidenti ka kryer një akt të paprecedent, duke tentuar të pezullojë një proces kushtetues me procedura ligjore administrative. Dispozitat kushtetuese, si dhe ato të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, që lidhen me emërimin dhe zgjedhjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe nuk mund të interpretohen në tejkalim të përmbajtjes që ato kanë: të garantimit të pavarësisë dhe funksionimit efikas dhe të pacenueshëm të një organi kushtetues, të rëndësisë së veçantë, siç është Gjykata Kushtetuese.

- Duke vepruar në shkelje të Kushtetutës dhe ligjit, Presidenti ka synuar të bllokojë emërimin/zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese që sjell zvarritjen e rifillimit të funksionimit të kësaj Gjykate. Për më tepër, ky veprim synon të ndikojë në cenimin e

pavarësisë së këtij institucioni nëpërmjet ndërhyrjeve antikushtetuese në procedurat e emërimit të gjyqtarëve të kësaj Gjykate.

- Presidenti, në mënyrë të përsëritur, ka kryer veprime në kundërshtim me Kushtetutën, duke nxjerrë akte në tejkalim ose në mungesë të kompetencës së tij kushtetuese dhe ligjore.

### **Për sa më sipër:**

Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje, në radhë të parë, Gjykatës Kushtetuese, të marrë përsipër përgjegjësinë e autoritetit që i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, për të mos lejuar delegitimimin institucional që me fillimin e veprimtarisë së tij, por të zbatojë urdhërimin kushtetues të renditjes së përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që përcakton znj. Arta Vorpsi si gjyqtare të emëruar të Gjykatës Kushtetuese. Çdo tentativë apo veprim tjetër që synon zbatimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 350, datë 13.11.2019, për emërimin e znj. Marsida Xhaferllari si gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese dhe që konsiderohet në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën dhe me ligjin, ngarkon me përgjegjësi cilindo që do të guxojë të ndërmarrë këtë veprim me pasoja të rënda për funksionimin e shtetit të së drejtës.

Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të tjera të zbatojnë me përgjegjësi detyrat, pa krijuar asnjë pengesë, për fillimin e ushtrimit të detyrës së gjyqtareve kushtetuese znj. Arta Vorpsi, znj. Elsa Toska dhe znj. Fiona Papajorgji, të emëruara në mënyrë legjitime sipas procedurës kushtetuese, të zhvilluar për këtë qëllim nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe Kuvendi i Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë i bën thirrje Presidentit të Republikës të heqë dorë nga tentativat dhe aktet që bllokojnë zbatimin e Reformës në Drejtësi dhe funksionimin normal të organeve kushtetuese, ku një prej më të rëndësishmeve është Gjykata Kushtetuese.

Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë të përsëritur, i bën thirrje Presidentit të Republikës të reflektojë duke kthyer institucionin e Presidentit në kufijtë e kompetencave të njohura nga Kushtetuta dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër në shkelje flagrante të Kushtetutës.

Kuvendi i Shqipërisë, në kuadër të shmangies së çdo tentative për bllokimin e Reformës në Drejtësi, angazhohet të rishikojë legjislacionin për të shmangur krijimin, në të ardhmen, të situatave që pengojnë në mënyrë abuzive funksionimin e organeve kushtetuese të vendit.

Miraturar në datën 15.11.2019